



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT

AN280320230003

Tiranë, më 24.04.2023

Komisioni 44

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “KAPAJ” Sh.p.k.

Nr. NIPT-i: K02715455C

Adresa e selisë: Frakull e Madhe, Fier

Personi përgjegjës: Matilda Kapaj

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzim i konglomeratit në sipërfaqen e zgjeruar të lejes së shfrytëzuar**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Zona Minerare 1741/1, në fshatin Frakull e Vogël, Njësia Administrative Frakull, Bashkia Fier

Të dhëna teknike:

Sipërfaqe: 0.200 km²

Lloji i mineralit: *Konglomerat*

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen: Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislationit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së ushtrimit të aktivitetit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme: - Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”; - Të spërkaten rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”; - Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”. Gjithashtu me qëllim mbrojtjen e mjedisit, përdorimi i lëndëve plasëse, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”. - Në zbatim të legjislationit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit. - Sugjerojmë që mbetjet e gjeneruara gjatë zhvillimit të aktivitetit të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve. Sugjerojmë të merret mendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Spektori i mbrojtjes së natyrës sugjeron që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet t’i përmbahet legjislationit në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve: Ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar; Ligjit nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar, si dhe të bëjë rehabilitimin e zonës me mbjellje pemësh. Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedi

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet projekti “Shfrytëzim i konglomeratit në sipërfaqen e zgjeruar të Lejes së shfrytëzuar”, në fshatin Frakull e Vogël, Njësia Administrative Frakull, Bashkia Fier, me zhvillues “KAPAJ” dhe aplikues “Environmental Management Consultants” me nr. Aplikimi AN280320230003, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër shprehet Verifikimi në objekt për inspektimin e subjektit nga specialistët e Lejeve dhe VNM-ve për dhënien e mendimit për VNM u mbështet në Ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligjin Nr.10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Vendimin numër 686, datë 29.07.2015 “Për

miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe akteve nënligjore mjedisore në fuqi, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë ngriti grupin e punës më datë 20.04.2023 për Subjektin: “Kapaj” sh.p.k me Aktivitet: “Shfrytëzim i konglomeratit në sipërfaqen e zgjeruar të lejes së shfrytëzuar”, me vendodhje: Njësia administrative Frakull e Madhe, Fshati Frakull e Vogël, Bashkia Fier, Qarku Fier. Aktiviteti që do të zhvillohet mund të shkaktojë rritje të shkallës së erozionit. Pjerrësia e terrenit mund të bëhet shkak që grimcat e tokës të ekspozohen ndaj agjentëve atmosferikë duke u shpërndarë dhe lëvizur jashtë zonës së shfrytëzimit duke krijuar mundësi potenciale për ndotje të mjedisit. Sugjerime: • Të bëhet menaxhimi i mirë i mbetjeve sterile dhe dherave që do të prodhohen gjatë fazës së studimit për zbulimin e mineralit në zonë dhe fazës zhvillimore të shfrytëzimit të karrierës. • Të evitohet efekti i mundshëm i erozionit në zonë.

Mbetjet inerte që do të gjenerohen nga procesi i punës të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" • Të bëhet sistemimi i dherave në sheshet e punës për të gjithë sipërfaqen që do të shfrytëzohet për të krijuar sipërfaqet për mbjellje pemësh të zonës duke përmirësuar dhe peisazhin natyror dhe rritur cilësinë e ajrit në zonë. • Mbetjet sterile dhe inerte të ripërdoren për rehabilitimin e zonës së shfrytëzimit dhe për ndërtimin e një sërë rrugësh të brendshme në zonën e marë në studim. • Të përdoret ujë për lagjen e territorit në formë shpërkatje për shmangien e pluhurave. • Të monitorohet niveli i zhurmave sipas Udhëzimit Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara. • Të zbatohet legjislacioni mjedisor në fuqi gjatë fazës së studimit dhe shfrytëzimit të objektit sipërfaqësor mineral. • Territori ku kryhet aktiviteti duhet të rrethohet me tabela paralajmëruese ku të tregohet për punimet që kryhen, rradhën e kryerjes së tyre dhe rrezikshmërinë. • Të kryhet rehabilitimi përfundimtar pas shfrytëzimit të karrierës, shesheve të depozitimit të sterileve etj. • Të llogariten distancat e rrezikshme nga përdorimi i lëndëve plasëse, nëse do të duhet të përdoren, duke rritur maksimalisht sigurinë në territor. • Lidhur me sigurinë e jetës së punonjësve në territor të përdoren pajisje mbrojtëse të cilat evidentojnë dhe shpëtojnë jetë. • Shpërthimet dhe plasjet me eksploziv të kryhen në orare të tilla që zhurmat të kenë ndikim minimal në zonën përreth dhe të mos kenë efekte në banesat e komuniteteve lokale. Në rast se do të ketë dëme materiale për efekt të kryerjes së operacioneve kërkimore zhvillimore në karrierë nga kompania Kapaj Shpk të realizohet dëmshpërblimi sipas legjislacionit vendas në fuqi. • Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës të vendosen sinjalistikat përkatëse duke ju krijuar mundësinë punonjësve dhe banorëve të komuniteteve zonal të orientohen sipas rregullave në zonat me karakter industrial. • Nëse do të kemi ndërhyrje në rrugët e aksesit në zonën përkatëse këto do të nevojitet të realizohen me projekte të studiuara mirë duke u marë në konsideratë dhe rehabilitimi i plotë i mjedisëve të dëmtuara nga ndërhyrjet siç parashikohet në legjislacionin mjedisor. • Objekti do të duhet të shfrytëzohet me karrierë por me parametra të rregullt dhe shkallë me lartësi 10-12 m si metodë e përshtatshme dhe më të leverdisshme e shfrytëzimit të vendburimit të pakos konglomeratike.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: U krye në datën 10.03.2023. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve

negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve. Kërkesat e pjesëmarrësve, do të mbahen parasysh, në fazën kur shoqëria do të fillojë procedurat për fazën e shfrytëzimit.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 44, datë 20.04.2023, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.75, datë 07.04.2023, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
- Shkrese Nr 6148/3 prot., datë 30.11.2022 “Mbi aplikimin për fillim procedure per zgjerim e lejes Nr.1741, date 10.02.2015, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me subjektin “KAPAJ” Sh.p.k.
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.

4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.

4.4 **Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.** Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.

4.5 Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zona me status të vecantë.

Gjatë fazës së instalimit:

4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.

4.7 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)

4.8 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.

4.9 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislationit në fuqi.

4.10 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.

4.11 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.

- 4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimi të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 **Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.**
- 4.15 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.18 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.19 Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.20 **Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.**
- 4.21 **Personi përgjegjes teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.**
- 4.22 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.23 Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.24 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.25 Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.26 **Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.**

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodi citeti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	26.10.2023	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	26.10.2023	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	26.10.2023	Çdo 6 muaj

Tabela e niveleve kufi:

- **Shkarkimet në Ajër**

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	26.10.2023	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	26.10.2023	Çdo 6 muaj

- **Cilësia e ujrave**

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodicite ti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	26.10.2023	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- **Afati i Vlefshmërisë**

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.

- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

MINISTRI


MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Harta me Koordinatat (sipas MIE)

Leja Minerare Nr.1741/1




MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
 DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE DHE INDUSTRIË
 OBJEKTI "Frakull e Vogël", Qarku Fier

Leja nr. 1741/1
 Subjekti "KAPAJ" sh.p.k
 Minerali Konglomerat
 Lloji i lejes Shfrytëzimi
 Sipërfaqja, km² 0.200
 data
 Neritan Aleks 04.11.2022

firma


Kordinatat

Pika	X	Y
1	4500044	4375627
2	4500123	4375530
3	4500344	4375736
4	4500555	4375572
5	4500858	4375929
6	4500605	4375979
7	4500542	4376091
8	4500443	4376067

